



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K2/I9-6 Prot.
Nr. Dok. 202502875/6

Tiranë 06/08/2025

Lënda: Rekomandim mbi marrjen e masave për trajtimin me dinjitet të trupave të të ndjerëve, nga Instituti i Mjekësisë Ligjore, si dhe planifikimin e investimeve për të shtuar kapacitetin e morgut në spitalet rajonale publike.

MINISTRISË SË DREJTËSISË
Tiranë

INSTITUTIT TË MJEKËSISË LIGJORE
Tiranë

Të nderuar,

Media JetaOshQef, ka publikuar në datën 12.06.2025, në faqen e saj joq-albania.com, një lajm¹ ku pretendohet se, trupi i një të riu të paidentifikuar, i cili kishte kryer vetëvrasje, duke u hedhur nga Godina nr.12, e Qytetit Studenti, ishte lënë në kushte dekompozimi.

Kjo media shkruante se për arsye etike nuk kishte publikuar fotot ku provohej kjo gjendje e neglizhencës për rastin në fjalë.

Referuar nenit 13, paragrafi i parë, të Ligjit nr.8485, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar, në të cilin parashikohet se: "Avokati i Popullit fillon procedurën e shqyrtimit të çështjes kur vëren ose dyshon se ka ndodhur një shkelje e së drejtës, në bazë të ankesës apo të kërkesës së personit të interesuar ose të dëmtuar, **si dhe me nismën e vet**, për raste të veçanta të bëra publike", Avokati i Popullit

¹ <https://joq-albania.com/artikull/1279227.html>

vlerëson se, kjo çështje përmban elemente për t'u marrë në shqyrtim me nismën e institucionit tonë.

Për të verifikuar këtë lajm, kemi kërkuar informacion në Institutin e Mjekësisë Ligjore, nëse ishte respektuar procedura e ruajtjes së trupit të të riut, i cili raportohet se kishte kryer vetëvrasje, dhe nëse kishte patur problematika lidhur me gjendjen e frigoriferëve të morgut apo të mbingarkesës me trupa të njerëzve të vdekur.

Gjithashtu, kemi kërkuar informacion në Komisaratin e Policisë nr. 1, Tiranë, nëse ishte identifikuar personi, i cili kishte kryer vetëvrasje, duke u hedhur nga Godina nr.12, e Qytetit Studenti.

Komisariati i Policisë nr.1, Tiranë na ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 5344/1 Prot., datë 04.07.2025, ku informohemi për sa më poshtë:

“Në datën 07.06.2025, rreth orës 20:00, jemi njoftuar nga Salla Operative se tek “Qyteti Studenti”, në lulishten e Godinës nr.12, ishte hedhur një shtetas nga lartësia. Menjëherë është ngritur grupi hetimor, ku është shkuar në vendin e ngjarjes dhe në prezencë të ekspertit kriminalist është bërë kqyrja e vendit të ngjarjes si dhe fiksimi i të gjitha provave të evidentuara nga eksperti kriminalist. Pas përfundimit të veprimeve hetimore, kufoma është marrë nga ambulanca e morgut ku është transportuar drejt Mjekësisë Ligjore, për t’ju nënshtruar këqyrjes së kufomës. Në lidhje me këtë ngjarje janë pyetur disa persona të ndryshëm, pjesëtar të stafit të Godinës nr.12 të “Qytetit Studenti”. Këqyrja e kufomës është kryer në datën 08.06.2025, në prezencë të ekspertit kriminalist dhe ekspertit mjeko-ligjor.

Gjatë verifikimeve të kryera, është bërë e mundur identifikimi i kufomës së shtetasit H.D, i datëlindjes 26.01.1994. Është pyetur në cilësinë e personit që ka dijeni për ngjarjen, nëna e viktimës, shtetësja A.D, e cila e ka njohur kufomën. Kësaj shtetasje i është marrë edhe një profil AND, për t’ju nënshtruar ekspertimit biologjik krahasues.

Janë kryer të gjitha veprimet hetimore dhe procedurale dhe materialet janë referuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me shkresën nr. 5508/K Prot., datë 11.06.2025”.

Instituti i Mjekësisë Ligjore, na ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 6446/1 Prot., datë 02.07.2025, ku informohemi për sa më poshtë:

“Trupi i pajetë i të ndjerit, në datën 07.06.2025 është dërguar pranë morgut të Institutit të Mjekësisë Ligjore në gjendje të mirë, sipas deklaratave të punonjësve përkatës. Megjithatë, më pas është konstatuar se trupi është lënë jashtë frigoriferit për një periudhë kohe, në kundërshtim me Urdhrin nr. 5111, datë 14.05.2025, të titullarit të

Instituti të Mjekësisë Ligjore, duke sjellë si pasojë shfaqjen e disa ndryshimeve kufomore.

Për këtë rast, Instituti i Mjekësisë Ligjore nisi procedimin disiplinor për disa punonjës, duke marrë dhe masat disiplinore përkatëse, për njërin është propozuar zgjidhja e marrëdhënies juridike të punës duke qenë se ka përgjegjësi direkte për vendosjen në frigorifer për trupin e të ndjerit dhe për një nga punonjësit, i cili ka lejuar të hyjë një qytetar për të identifikuar të ndjerin pa praninë e oficerit, i është dhënë masa disiplinore “Vëretje me paralajmërim për përfundimin e kontratës individuale të punës”.

Sa i përket funksionalitetit të frigoriferit në morg, ju bëjmë me dije se gjatë kësaj kohe nuk është konstatuar problematikë teknike, por si pasojë e ndërprerjes së rrymës elektrike për shkak të punimeve duke qenë se kemi qenë në rikonstrukcion herë pas here është bërë monitorimi i tyre. Megjithatë, ajo që ka rënduar situatën është mbingarkesa e vazhdueshme përtej kapaciteteve të disponueshme. Aktualisht për shkak të mbingarkesës së frigoriferëve kufomambajtës, institucioni ynë e ka të vështirë të menaxhojë flukset në rritje të rasteve, veçanërisht gjatë periudhës së verës. Për të mundësuar vijueshmërinë normale të shërbimit, kemi qenë të detyruar të transferojmë disa trupa në morgun e Spitalit Rajonal Fier dhe atë të Spitalit Rajonal Elbasan.

Megjithatë edhe në këto struktura, situata paraqitet drejt mbingarkesës sikurse edhe në morgun e IML-së Tiranë, ndërkohë që procedurat e varrimit janë shpeshherë të zgjatura dhe të ndërlikuara.

Institucioni ynë është i vetëdijshëm për rëndësinë e respektimit të dinjitetit të të ndjerëve dhe standarteve profesionale, dhe për këtë arsye janë ndërmarrë hapa konkrete për përmirësimin e kapaciteteve dhe shmangien e situatave të tilla në të ardhmen. Konkretisht jemi drejt përfundimit të ambientit të ri të morgut me një kapacitet prej rreth 100 vende kufoma mbajtës”.

Vlerësimi i Institucionit të Avokatit të Popullit

Hetimi administrativ i këtij rasti, nxorri edhe një herë në pah mungesën e kapaciteteve në morgun e institucioneve publike, duke na risjellë në kujtesë pamjet e morgut në kohën e pandemisë, ku trupat e personave, të cilët kishin humbër jetën për shkak të virusit COVID-19, ishin lënë në dysheme, të mbuluar me çarçafë².

Në të gjitha shoqëritë, respekti ndaj të vdekurve, përmes zakoneve dhe ritualeve specifike, është pothuajse universal. Ideja se i ndjeri meriton trajtim dinjitoz është thellësisht e rrënjësuar në tradita të ndryshme shoqërore, fetare dhe kulturore.

² <https://kohajone.com/aktualitet/pamje-te-renda-publikohen-fotot-morgu-i-tiranes-pertej-kapacitetit-trupat-lihen-pertoke/>

Në kulturën e vendit tonë, kujdesi për të vdekurin, është i rregulluar me të drejtën tonë zakonore, por gjithashtu edhe me legjislacionin e miratuar për mënyrën si duhet të trajtohet trupi i të ndjerit.

Më konkretisht, legjislacioni që mbulon këtë fushë, është si vijon:

- Ligji Nr.7830, datë 15.06.1994 “Për autopsitë”

Neni 9

“Mjeku specialist që kryen autopsinë, duhet të veprojë me takt dhe të marrë të gjitha masat që kufoma t’u paraqitet pas autopsisë të afërmeve të saj në gjendje normale, duke respektuar kështu të gjitha ndjenjat e tyre”.

- Ligji Nr.10 454, datë 21.07.2011 “Për transplantimin e indeve, të qelizave dhe të organeve në Republikën e Shqipërisë”

Neni 24 (Respekti për trupin e njeriut)

“Gjatë heqjes së organit apo indit dhe gjatë ekzaminimeve pas vdekjes, trupi i njeriut duhet të trajtohet me respekt dhe të gjitha procedurat duhet të realizohen në mënyrë të tillë që trupi të mund të rikthehet në pamjen e tij origjinale sa më shumë që të jetë e mundur”.

- Ligji Nr.9220, datë 15.04.2004 “Për administrimin e shërbimit të varrimit”
- Kodit Penal

Neni 118 (Dhunimi i varreve)

“Dhunimi i varrezave, varreve, nxjerrja e kufomës, si dhe vjedhja e sendeve që mund të ndodhen në to, si dhe çdo veprim tjetër që ul respektin ndaj të vdekurve, dënohen me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet”.

Legjislacioni i vendit tonë, i cituar më lart është në përputhje me Rekomandimin nr. R (99)3, datë 2 Shkurt 1999, të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës “Mbi harmonizimin e rregullave të autopsisë mjeko-ligjore”³, ku në kreun IV (Rregulla të përgjithshme), pika 1, rekomandohet që: “Autopsitë mjeko-ligjore dhe të gjitha masat që lidhen me këtë ekzaminim, duhet të kryhen në një mënyrë që është në përputhje me etikën mjekësore dhe duke respektuar dinjitetin e të ndjerit”.

³ [https://www.coe.int/t/dg3/healthbioethic/texts_and_documents/recr\(99\)3.pdf](https://www.coe.int/t/dg3/healthbioethic/texts_and_documents/recr(99)3.pdf)

Po ashtu, në kreun V (procedura autopsisë), pika 7 (kthimi i trupit), rekomandohet që: *“Pas kryerjes së autopsisë mjeko-ligjore, eksperti mjeko-ligjor duhet të sigurojë që trupi të kthehet në një gjendje dinjitoze”*.

Trajtimi i papërshtatshëm ose i pahijshëm i të vdekurve, shkakton vuajtje shpirtërore të të afërmit e të ndjerit, të cilët ruajnë lidhjen nëpërmjet kujtimeve dhe veprave.

Kujdesi për trupin e të vdekurve, është thelbësor gjithashtu, për të siguruar hetime të suksesshme. Të gjitha provat duhet të mblidhen dhe të analizohen, duke ndjekur protokollet dhe procedurat ligjore. Në të kundërt, identifikimi i gjurmëve dhe kryerja e analizave mund të cënohen duke e bërë të vështirë zbulimin e fakteve për vdekjet jo natyrale. Hetimet efektive në këto raste, do të ndihmojnë autoritetet ligjzbatuese dhe familjarët të zbulojnë të vërtetën.

Prandaj, detyrimi i institucioneve për të mbrojtur trupin e të vdekurit, është i rëndësishëm për përmbushjen e të drejtave të familjarëve të të ndjerit, dhe për të siguruar që të gjitha vdekjet jo natyrale të hetohen plotësisht. Në çdo rast dhe rrethanë të një vdekjeje, trupi i të ndjerit duhet të trajtohet me dinjitet dhe respekt, dhe të ruhet siç duhet, duke ndjekur procedurat zinxhir të përkujdesjes.

Vlerësojmë faktin që janë ndërmarrë masa për adresimin e këtij problemi, për të shtuar kapacitetin e morgut të Institutit të Mjekësisë Ligjore, me 100 vende kufoma mbajtës, nga 17 vende që ka aktualisht, por deri në përfundimin e investimit, gjendja e trupit të të ndjerit H.D u përkeqësua duke passjellë trajtim jo dinjitoz të pakthyesëm.

Shtimi i kapaciteteve, nuk duhet të kufizohet vetëm në mjediset e morgut të Institutit të Mjekësisë Ligjore, por të vlerësohet edhe mundësia e përmirësimit të gjendjes së morgut në spitalet rajonale publike, për t’iu përgjigjur në mënyrë efektive fluksit në rritje të rasteve si dhe duke patur parasysh rekomandimet e dhëna nga organizatat ndërkombëtare, si Organizata Botërore e Shëndetësisë, për të patur 1 hapësirë frigoriferike për çdo 25,000 – 50,000 banorë në kushte normale (jo gjatë emergjencave).

Në këto kushte, çmujmë se duhet të merren masa për trajtimin me dinjitet të kufomave, deri në përfundimin e investimit që po kryhen në Institutin e Mjekësisë Ligjore, dhe t’i kushtohet vëmendje e veçantë sigurimit të burimeve financiare, për të shtuar kapacitetet në morgun e spitaleve rajonale publike në të gjithë vendin.

Për sa më lart, bazuar në nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut”* si dhe në mbështetje të nenit 21/c të Ligjit Nr.8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku

përcaktohet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi epror i organit që ka shkaktuar shkeljen.”

REKOMANDOJMË:

- Marrjen e masave për trajtimin me dinjitet të trupave të të ndjerëve, nga Instituti i Mjekësisë Ligjore.
- Deri në përfundimin e investimit për rikonstruktimin e godinës së Institutit të Mjekësisë Ligjore dhe shtimit të kapacitetit të morgut në këtë institucion, të merren masa urgjente për krijimin e kushteve aktuale, për garantimin me dinjitet të kufomave.
- Marrjen e masave për të shtuar kapacitetet në morgun e spitaleve rajonale publike në të gjithë vendin.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, lutemi na vini në dijeni brenda afatit ligjor 30 ditor, të parashikuar në nenin 22 të Ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Besnik DEDA

D.V